

VENDIM
Nr. 220, datë 27.10.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 136/3 prot., datë 18.10.2021, nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k., me shkresën nr. 253 prot., datë 14.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 1001 prot., datë 14.10.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e regjistrimit për aplikim, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Aplikimi i shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a” dhe “b”), plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “c” dhe “d”), plotësuar;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat: “c”, “d”, “g”), plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim neni 9, pika 1, germa “c” (të dhëna për aplikuesin);
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor neni 9, pika 2, gjerat “a” dhe “b” (akti i themelimit dhe statuti), germa “c” (vërtetim për regjistrimin dhe ekstrakti historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)), germa “d” (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata) dhe germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë);

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “b” (paraqitje bilanci financiar i tre viteve të fundit);

- dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germa “a” (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve), germa “b” (kapitali financiar i shprehur në vlera financiare), germa “c” (sistemi IT), germa “h” (të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar), germa “i” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët), do të njoftohet subjekti që, në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti